



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 56/12
Prishtinë, më 2.04.2012, ora 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
IMBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadërgjonaj, Naser Osmani, Jelena Bontic, Latif Gashi, Hasime Krasniqi., Hykmete Bajrami, Sali Asllanaj, Duda Balje, Xhevdet Neziraj, Muhamet Mustafa dhe Albana Fetoshi.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini dhe Dashurije Canolli.

Gjithashtu ishin të pranishëm: Safet Hoxha kryetar i KRPP-së, Hysni Hoxha kryetar i OSHP-së, Raif Preteni Drejtor i ZRRUM-it, Ahmet Krasniqi dhe Gani Asllani zv. udhëheqës i AKK, Rejhane Zylfijaj nga GIZ, monitorues nga OSCE, KDI.

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadërgjonaj, Kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të komisionit në datat 22.03.2012 dhe 23.03.2012;**
3. **Shqyrtimi i Raportit vjetor të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për vitin 2011;**
4. **Shqyrtimi i Raportit vjetor të Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2011;**
5. **Shqyrtimi i Raportit financiar të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës për vitin 2011;**
6. **Shqyrtimi i Raportit financiar të Zyrës Rregullative për Ujësjellës dhe Mbeturina për vitin 2011;**
7. **Shqyrtimi i Projektligji nr.04/L-066 për Qendrën Historike të Prizrenit me Raportin me amendamente të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor;**
8. **Shqyrtimi i Raportit me amendamente të Grupit Punues të Komisionit për Buxhet për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-146 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar;**
9. **Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja, propozoi që rendi i ditës të plotësohet me një pikë: Shqyrtimi i projeksioneve të buxhetit për RTK-në për periudhën prill-qershor 2012 dhe të jetë pika e tretë, meqë përmes stafit në mënyrë elektronike jeni njoftuar se kjo pikë do të propozohet si pikë plotësuese.

Njëzëri miratohet rendi i ditës, me plotësimin e një pike të re: Shqyrtimi i projeksioneve të buxhetit për Radiotelevizionit të Kosovës për periudhën prill-qershor 2012 dhe do të jetë pika e tretë e rendit të ditës dhe në vazhdim bëhet rirenditja e pikave të rendit të ditës.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të komisionit në datat 22.03.2012 dhe 23.03.2012

Salih Asllanaj, theksoi se në proceverablin e dt. 22.03.2012, kur është votuar për amendamentet për Projektligjin për bankat, kam qenë kundër projektligjit dhe e kam justifikuar votën time.

Kryetarja, theksoi se meqë ka kryesuar ka evidentuar votimin për secilin amendament dhe për projektligjin në tërësi, po ashtu edhe administrata ka mbajtura shënimet dhe e gjithë mbledhja është e inxhizuar. Për qdo amendament kam kërkuar deklarinimin e anëtarëve se a janë për, kundër apo abstenim dhe sipas mënyrës së votimit janë regjistruar votat dhe anëtarët që kanë votuar. Dhe për dallim nga disa amendamente që nuk ka pasur konsensus, ku edhe janë evidentuar se si kanë votuar anëtarët me emër, me rastin e votimit të projektligjit në tërësi, nuk ka pasur votë të deklaruar kundër apo abstenim. Kjo ka qenë situata e votimit, por nëse doni të tërhiqni votën sot, mund ta bëni.

Albana Fetoshi, po ashtu theksoi se ka votuar kundër projektligjit për bankat dhe institucionet mikrofinanciare dhe kërkoj që të përmisohet procesverbali.

Hykmete Bajrami, theksoi se vota e saj për projektligjin për bankat ka qenë abstenim dhe duhet të korrigjohet në procesverbal.

Kryetarja, konstatoi se procesverbali i dt. 22.03.2012, miratohet me vërejtjet e bëra nga deputeti Asllanaj, deputetja Bajrami dhe deputetja Fetoshi.

Hykmete Bajrami, në procesverbalin e dt. 23.03.2012 kur është votuar për amendamentin e propozuar nga grupi parlamentar 6+ lidhur me projektligjin e RTK-së, nuk janë evidentuar votat për dhe kundër, megjithëse se ka pasur vota pro dhe kundër.

Kryetarja, theksoi se kur është kotu për implikime buxhetore për amendamentin e propozuar nga grupi parlamentar 6+ dhe projektligjin në tërësi nuk ka pasur votë kundër dhe është diqka tjetër çështjet që u ekzagjerua dhe politizua në seancë.

3. Shqyrtimi i projeksioneve të buxhetit për Radiotelevizionit të Kosovës për periudhën prill-qershor 2012

Sylejman Shaqiri, njoftojë se projeksionet janë hartuar në pajtim me shumën e ndarë me ligjin e buxhetit të Kosovës dhe sipas atyre standardeve të zakonshme të cilat e paraqesim kërkesën.

Komisioni njëzëri nxori këtë

REKOMANDIM

I rekomandohet Administratës së Kuvendit, të transferojë mjetet buxhetore nga buxheti i Kuvendit – kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, në xhirollogarinë e RTK-së nr.1110101219060187, për periudhën 1 prill – 30 qershor 2012, në shumën prej 2,065,000 Euro.

4. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për vitin 2011

Kryetarja, njoftoi se grupi punues 3 ka mbajtur tri takime, ku ndër të tjera është shqyrtuar edhe raporti i punës dhe financiar i KRPP-së. Në materialin të cilin e keni pas ne kemi vërejt si grup punues që të gjitha ato çështjet që janë të parapara më ligjin për prokurimin publik janë përfshi në raportin e KRPP-së. Mirëpo ne kemi pas vërejtje që nuk i kemi informatat e detalizuara në raportin financiar, për çka ju kemi drejtu si grup punues komisionit rregullativ që të na i sjellin të dhënat e detalizuara, dhe KRPP e ka sjell materialin më të detalizuar e kërkuara në lidhje me shpenzimet për vitin 2012.

Safet Hoxha, shkurtimisht prezantoi raportin e punës dhe financiar të KRPP-së për vitin 2012, ku ndër tjera theksoi e se nga 161 autoritete kontraktuese, është raportuar për 158 dhe pjesë e raportit nuk japë tri komunat e pjesës veriore, për shkak se nuk kemi pranuar raporte nga këto tri komuna, si ajo e Zveqanit, Zubin Potokut dhe Leposaviqit.

Kryetarja, theksoi se për qdo vit na vjen raporti për mosraportimit e tri komunave veriore, dhe për mua dhe anëtarët e komisionit është e rëndësishme të dijmë çka keni bërë ju në këtë drejtim që ti keni edhe ato raporte, kur dihet se edhe këto komuna e shfrytëzojnë buxhetin e Kosovës. E dyta në raportin e progresit ka qenë një vërejtje për mos nxjerrjen e vetëm 25% të legjislacionit dytësor. Me që është ndryshue ligji i prokurimit, deri ku keni arritur tash pas miratimit të ligjit me nxjerrjen e legjislacionit dytësor dhe a ka gjasa që ky legjislacion të kompletohet. E treta në raportin e progresit po ashtu është një vërejtje se nuk janë përdorë kontratat kornizë. Ne raportin thuhet që janë 201 kontrata kornizë, a mundeni të na tregoni pse nuk është përdorë kjo llojë kontrate më herët?

Latif Gashi, pyeti qfarë masa kushtetuese keni ndërmarrë që ti nisni procedurat ndaj autoriteteve kontraktuese që nuk kanë raportuar, është fjala për komunat veriore.

Safet Hoxha, sa i përket tri komunave veriore ne i kemi vu kontaktet përmes një anuarës së bordit fillimisht me zyrtarët e prokurimit në komunën e Zubinpotokut dhe sapo kanë filluar të sjellin njoftimet e kërkuar konform ligjit, autoritetet lokale i kanë kërcënuar dhe janë ndërprerë kontaktet zyrtare. Komuna Leposaviqit nuk ka pranuar fare të hyjë në biseda për raportim. Sa i përket legjislacionit dytësor, po flas me kompetencë që KRPP ka nxjerr gjithë legjislacionin dytësor që është i nevojshëm për prokurimin publik jo dhe atë 100%. Sa i përket kontratave kornizë vërejtja e komisionit evropian nuk i referohet përdorimit të kësaj kontrate si instrument ligjor sepse kjo është kontratë në maj 2010 është nxjerr për herë të parë. Po vërejtjet e komisionit evropian në këtë drejtim kanë të bëjnë më prokurimet e centralizuara, e që i referohen agjencisë qendrore të prokurimit apo ato që ne i njohim si prokurime të përbashkëta dhe janë mbi 200 kontrata për një vit.

Hykmete Bajrami, theksoi se pamvarsisht që thatë që këtu kemi thënë në raport një transparencë shumë të madhe dhe e lidhët këtë me kontrata të huaja, nuk e pata shumë të qartë se qfarë indikator është transparenca nëse 25.49% të fitueseve të tenderëve janë të kompanive të huaja edhe a e llogaritet edhe BektellEnka, e cila merr 1/4 e buxhetit vjetor brenda vitit mandej ndoshta kjo përqindja ndërron komplet në favor të kontratave të huaja. Një çështje tjetër që më intereson është bashkëpunimi i KRPP-së me

agjensionin kundër korrupsionit në rastet që ju i monitoroni kur shiheni që ka shkelje të cilat janë masat që ju i merrni?

Safet Hoxha, sa i përket bashkëpunimit me agjencinë kundër korrupsionit, ne kemi një memorandum bashkëpunimi dhe çka do që ne e evidentojmë dhe kurdo që ne e vlerësojmë se e gjetura jone rezulton më një shkelje e njoftojmë agjencinë dhe pastaj ajo mbetet punë e saj. Sa i përket masave ne nuk marrim asnjë masë sepse nuk na lejon ligji për me marr masa ne ju njoftojmë se nëse vlerësohet që kanë shkelje materiale i njoftojmë organet dhe personat përgjegjës.

Muhamet Mustafa, vlerësoi raportin gjithëpërfshirës, i cili mban mjaftë detaje dhe tregon një tendencë përmirësimi në disa segmente. Por megjithatë duhet ta shtojmë një pyetje nëse raporti tregon përmirësim, në anën tjetër perceptimi i opinionit është se korrupsioni është në rritje, janë këto dy gjëra që nuk shkojnë së bashku. Me vjen mire që ka fillue praktika e monitorimit të procesit. Ndoshta problemi është që edhe ata që i keqpërdorin paratë publike në procesin e prokurimit po behën gjithnjë më të sofistikuar në atë mënyrë që është vështirë për t'i zbuluar.

Salih Asllanaj, theksoi se është e vërtetë që perceptimi i opinionit është i tillë që ndoshta jemi vendi më i korruptuar në botë por zyra e prokurimit është hallka me e dobët që sulmohet. Atëherë ju e keni për detyrë që të bashkëpunoni edhe më shumë në mënyrë që rastet i paraqesim jo vetëm agjensionet korrupsion, tek njësia e krimeve ekonomike, por tash edhe opinionit që ta din dhe ata që abuzojnë me ligjin e prokurimit dhe le të hakmerren në zgjedhje. Më pëlqejë që është rritur numri i tenderëve të hapur dhe kjo është një shenjë pozitive statistikore edhe pse ndoshta në atë anë thelbësore mund më pas probleme të ngjashme.

Hasime Krasniqi, vlerësoi se raporti i plotëson të gjitha kushtet në pajtim me ligjin. Lidhur me korrupsionin dhe faktet të cilat i ofron raporti e duke u mbështetur në këto fakte, mund të themi se praktikisht kemi një përmirësim të kësaj gjendje në fushën e prokurimit publik. Dhe problemi lidhur me korrupsionin qëndron më tepër te perceptimi se sa te realiteti. Te shpenzimet komunale, duke ditur gjendje e rëndë të kompanive, mendojë se ndoshta do të ishte dashtë që ti sjellin faktuarat edhe para kohe apo më së voni me 15 dhjetor të mbyllet dorëzimi i fakturave dhe të përmbushen obligimet që i ka autoriteti rregullativ lidhur me keto kompani e mos të mbetet në buxhetin e juaj me 64.55%.

Xhevdet Neziraj, theksoi e është mirë komisioni për buxhet, të ketë si vërejtje që me rastin e hartimit dhe lejimit të buxhetit të ardhshëm të paralajmërohen tri komuna veriore, që nuk do të kenë mjete nëse nuk dorëzojnë raporte. Dhe në këtë drejtim pyetja ime është se a ka tentuar anëtarja e bordit të KRPP-së-Selvana të sigurojë raportet nga këto komuna kur shifet se paska të ardhura të mira. Një çështje tjetër, ka të bëjë me faktin se para disa ditëve agjensioni anti korrupsion përsëri del në media që fusha e prokurimit është një prej fushave më të korruptuara, ndërsa këtu marrim analiza të kundërta, keto janë ato dualizmit që po mundem me u shfaqë në këtë fushë.

Albana Fetoshi, lidhur me mosraportimit e tri komunave veriore, pyeti kush duhet të kërkojë llogari prej tyre që të raportojnë, pasi që dikush është përgjegjës për këtë punë, kur dihet se edhe ato komuna shfrytëzojnë buxhetin e Kosovës?

Safet Hoxha, sa i përket Silvanës kjo është antare e bordit është nga Shtërpca por realisht ajo pjesa veriore e trajtojnë si pjesëtare të serbve lojalë të qeverisë edhe nuk ka shumë komunikim edhe pse ka provuar. Më shumë përgjegjësi po e them që ka përmirësim në fushën e prokurimit publik. Monitorimi i të gjitha llojeve të kontratave është i pamundshëm nga ana jonë nuk kemi profesionist të natyrës tillë edhe nuk kemi fonde të mjaftueshme për të angazhuar ekspert. Megjithatë kemi filluar në monitorimin e disa kontratave siç janë ato me mirëmbajtjen sezonit dimëror dhe besoj që kanë me qenë të arritshme.

Kryetarja, theksoi se vërtet është e nevojshme të bëhet një monitorim i fushës së prokurimit publik, për të parë situatën në mënyrën që të ndryshohet perceptimi për korrupsionin se sa në realitet është gjendja, po tregojnë raportet. Nga ajo që u diskutua mund të përmbledhim se raporti është i metalizuar sipas kërkesave të ligjit për prokurimin publik, po ashtu edhe raporti financiar i plotëson standartet e raportimit të cilat janë standard ndërkombëtar të kontabilitetit të sektorit publik dhe LMFP.

Pas diskutimeve, Komisioni me Tetë votë Për (Safete Hadergjona, Jelena Bontic, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Sali Asllanaj, Muhamet Mustafa, Xhevdet Neziraj dhe Duda Balje), dy Abstenime (Hykmete Bajrami dhe Albana Fetoshi) dhe asnjë Kundër, nxori këtë

REKOMANDIM

I rekomandohet Kuvendit të miratojë raportin e KRPP-së për vitin 2011.

5. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2011

Kryetarja, njoftoi se grupi punues po ashtu ka mbajtur dy takime për shqyrtimin e raportit të organeve OSHP-së dhe kemi vërejtur se ato që kërkohej me ligj të paraqiten në raport janë prezantuar, si dhe raporti financiar është përgatitur mirë, megjithëse janë bërë disa lëshime duke përdorur teknika, ku janë prezantuar përqindje më të mëdha të realizimit të buxhetit se sa në të vërtetë janë.

Hysni Hoxha, kemi bërë ndryshimin e rregullorës së punës që e kemi miratë diku rreth vitit 2009 kemi pasur obligim ta përshtatim me ndryshimet e reja që janë bërë me ligjin e prokurimit dhe kjo ka ndryshuar mënyrën e punës në shqyrtimin e ankesave të prokurimit. Vitin e kaluar kemi pasur diku rreth gjithsej 490 ankesa prej tyre kanë qenë 30 ankesa të agjensionit të prokurimit publik ndërsa 367 kanë qenë ankesa të operatorëve ekonomik. Më pas tregoi për vendimet që janë marrur lidhur me këto ankesa dhe theksoi se OSHP me vendimet e marrura ka kursyer buxhetin e Kosovës në vlerë prej 4 milion€. Numri i ankesave është zvogëluar dukshëm krahasuar vitet e mëparshme. Ajo çka është karakteristike në vitin e kaluar rreth 8 autoritete kontraktuese kanë hezitu të zbatojnë urdhëresat tona dhe 7 autoritete i kemi gjobitur me gjobë, prej të cilave kemi realizuar 63 mijë euro. Sa i përket raportit financiar, e kemi ekzekutuar buxhetin 94.31%

Kryetarja, theksoi se në raportin e progresit është ngritur një çështje që ka të bëjë me shkeljen e rregullave të prokurimit që lenë të kuptohet se këto shkelje të rregullave të prokurimit janë edhe si shkak të rritjes së korrupsionit. Qfarë masa konkrete janë marrë nga OSHP-ja për reduktimin e kësaj dukurie në përmisimin e rregullave të prokurimit në mënyrë që mos të jetë pasojë e rritjes së korrupsionit. Po ashtu një qështje tjetër e ngritur në raportin e progresit thuhet se OSHP-ja ka shqiptuar vetëm një gjobë dhe atë në shumë të ultë, nga raporti e kuptojmë se janë shqiptuar 7 gjoba, një sqarim për këtë? Një qështje tjetër e rëndësishme e ngritur në raportin e progresit, thuhet se ka ndërthurje të kompetencave në mes të tri organeve të prokurimit. Çka më intereson të dijë nga ju është se a keni pasur probleme të kësaj natyre dhe a keni ndërmarrë ndonjë masë për eliminimin e këtyre problemeve?

Hysni Hoxha, sa përket shkeljes së rregullave të prokurimit të paraqitura në raportin e progresit i atribuohet ekskluzivisht operatorëve ekonomik dhe është shumë normal që edhe ata thjesht bëjnë shkelje por të riparueshme. Shkeljet janë disa herë më të vogla krahasuar me vitin 2008. Sa i përket vërejtjes së paraqitur në raportin e progresit ka të bëjë me vitin 2010 dhe në vitin 2011 kjo gjendje ka ndryshuar. Sa i përket qështjes së ndërthurjes së kompetencave, deri në miratimin e ligjit të ri i kemi shqyrtuar ankesat ndaj KRPP-së dhe tani nuk e kemi këtë të drejtë unë. Mendoj që nuk kemi ndeshje të kompetencave por kemi ndonjëherë anashkalim të ligjit. Në rast se kemi pasur një ankesë në OSHP e cila ka nxjerrë një vendim dhe më

pastaj autoriteti kontraktues i pakënaqur me atë vendim i drejtohet KRPP-së, i cili ka nxjerr vendimin më të mirë dhe mund të kualifikohet anashkalim i ligjit, sepse vendimet e OSHP-së janë të formës prerë.

Latif Gashi, lidhur me vërejtjen e paraqitur në raportin e progresit për shqiptimin e vetëm një gjobe dhe atë minimalisht i ofruar sqarimet, më intereson të dijë çka keni bërë ju si institucion, qfarë masa keni marrë ta njoftoni opinionin apo ta njoftoni qoftë edhe Brukselin që të përmissohet ai gabim i paraqitur në raport, apo të ndryshohet imazhit i keq kur dihet se na ndoshta edhe në mungesë të informacioneve nëve raporti i progresit po na del gjithmonë keq apo qoftë edhe në dhënien e dezinformatave nga njerëzit që nuk ia donë të mirën Kosovës.

Hykmete Bajrami, z.Hoxha ju thatë që në raport keni pas prej 386 ankesa, prej të cilave 71 raste janë anulua komplet këtu sigurisht janë anulua pasi që është shpall fituesi edhe keto paraqesin shkelje të mëdha, në këtë kontest pyetja ime është a nuk do të meritonin këto gjoba? Mandej të gjobat është vlere e vogël dmth varsishte nëse kemi pas 7 raste total gjobat janë 132mij euro edhe këtu thuhet që ka pas raste kur përkundër vendimit të OSHP-së, është shpërblye operatori i njëjtë me kontratë, pyetja shtrohet sa është demtu buxheti i Kosovës, pasi këtu kanë mundur të jenë kontrata shumë të mëdha. Korrupsioni është gjithëpërfshirës dhe janë edhe institucionet tjera kompetente për luftimin e kësaj dukurie. Ju thatë vetë që keni caktua gjoba mandej keto autoritetet kontraktuese kanë shku edhe një hap më tutje në gjykatën supreme dhe janë gjobat të cilat nuk janë ekzekutuar ende, rasti i ART-së. Pikërisht për këto arsye është krijuar perceptcioni për korrupsionin e lartë dhe qdo ditë në media kemi informata që njerëzit familjar të zyrtarëve shumë të lartë, në nivel të ministrave shpërblehen me kontrata dhe nuk ka se si kjo shoqëri mos të mendojë që korrupsioni është i lartë.

Muhamet Mustafa, theksoi se kur i analizojmë keto raporte të KRPP-së dhe OSHP-së neve na del një fotografi mjaftë inkurajuese në angazhim, kur e analizojmë perceptimin si harxhohen paratë publike, nëse i shikojmë të dy gjanat këtu mund të egzistojnë dy probleme ose raportet, angazhimi nuk është real ose ne nuk jemi në gjendje në botën e jashtme ose opinionin kosovar nuk jemi në gjendje më dhënë një rekomandim të situatës. Psh prej këtyre raporteve del se prej 12.310 kontratave që janë bërë vjetë kemi pas vetëm 386 ankesa 3% edhe tash prej këtyre 3% shumica janë aprovua ose janë rrit tenderët shumë pak ka pas që janë refuzu ose anulua.

Kryetarja, theksoi se ne edhe nga ana e Brukselit kemi pas sugjerime nga personat kompetente atje nëse vërtetë shënohet diqka që nuk është reale atëherë duhet fillohet të komunikohet më Brukselin me letra. Prandaj, nëse KRPP-ja ose OSHP-ja ose institucioni cili do qoftë e shihet që diqka në raportin e progresit është shënuar dhe në fakt nuk qëndron ajo gjë aty duhet të komunikohet me letra jo vetëm me një raportim që bëhet në Bruksel me një ftesë të caktuar, por të raportohet me shkresa. Unë në vizitën që kishim, ju kam thënë që nëse ligji për prokurim është punu keq atëherë adresa është tek ju sepse ne e kemi punu siq keni than ju dhe kemi punu bashkarisht dhe shumë më vështirësi kemi ndryshu diqka që ata kanë qen insistues dhe kemi mujtë me bërë ndryshime që nuk janë edhe aq sa ne kemi deshtë si komision jeni dëshmitar të gjithë.

Latif Gashi, theksoi se në bazë të raporti del që ka një progres në fushën e korrupsionit. Pra duhet punë më e madhe që të njoftohet opinionin i brendshëm dhe i jashtëm që të ndryshojë perceptcioni për korrupsionin, pasi që raportet po e thonin të kundërtën nga ajo që mendohet. Sa i përket shqiptimit të gjobave minimale menodjë se janë shumë të vogla dhe kjo ka mundur të ndikojë në imazhin e institucioneve të Kosovës.

Hasime Krasniqi, lidhur me këtë që diskutohet në raport, theksoi se ne jemi njerëzit me përgjegjësi për shpenzimin e parasë publike por duke u bazë në keto raporte që na vijnë neve ne duhet ta interpretojmë tek opinionin këtë që ndodh duke u bazë në fakte. Pres nga OSHP-ja një angazhim edhe me të madh lidhur me shpenzimet që janë bërë në bazë të raportit në bazë të fakteve të ofruara do ta keni edhe mbështetjen edhe

nga ana e komisionit tonë për një angazhim më të madh rreth realizimit të këtyre padive, shkresave dhe ankesave dhe nëse kemi mundësi ne që të ndikojmë tek ato autoritete që të bahet edhe inkasimi i këtyre mjeteve të merren masa konkrete dhe të realizohen dhe mos ta humbin besimin ndoshta edhe operatorët ekonomik kur paraqitet masa ndëshkuese dhe nuk realizohet.

Hysni Hoxha, me qenë se ka përmisime në fushën e prokurimit. Sa i përket 7 rasteve të aplikimit të gjobës se mos eventualisht është dëmtua buxheti i Kosovës po ju them më përgjegjësi të plot se gjithë ato autoritete të cilat kanë dashtë të mos ta zbatojnë vendimin tonë të ia japin dikujt tjetër pikërisht për këtë edhe iu kemi shqiptu gjoba. Si OSHP po ballafaqohemi me sfida, ne na duhen minimumi dhjetë ekspert vendor apo më shumë sepse më ligjin e ri ndryshimet e reja që janë bë nuk guxojnë të angazhojmë ekspert të jashtëm.

Pas diskutimeve, Komisioni me tetë votë Për (Safete Hadergjonaj, Jelena Bontic, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Sali Asllanaj, Muhamet Mustafa, Xhevdet Neziraj dhe Duda Balje), një Abstenim (Hykmete Bajrami) dhe asnjë Kundër, nxori këtë

REKOMANDIM

I rekomandohet Kuvendit të miratojë raportin e OSHP-së për vitin 2011.

6. Shqyrtimi i Raportit financiar të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës për vitin 2011

Kryetarja, njoftoi se grupi punues i ka mbajtur dy takime që është shqyrtu raporti vjetor i financiar i autoritetit kosovar të konkurrencës. Në takimin e parë ne i kemi bërë një shkresë dhe iu kemi drejtuar autoritetit të jep sqarime në lidhje me disa shpenzime ku grupi punues ka vërejt që janë shpenzime më të mëdha, ka qenë çështja e udhëtimit jashtë vendit dhe shpenzimet karburanteve kanë qenë më të larta.

Ahmet Krasniqi, njoftoi se arsye e shpenzimeve jashtë vendit është se katër herë ftohemi në Bruksel për të raportuar për raportin e progresit dhe jemi të detyruar me shuke dhe përpos asaj i kemi edhe disa udhëtime që ka pas shumë nevojë për trajnime se konkurrenca është një lëmi pak e re për shtetin e Kosovës.

Gani Asllani, prezantoi nivelin e buxhetit të shpenzuar nga AAK-ja dhe njoftoi se mosrealizim i buxhetit në total ka ndodh për arsye që ne ende nuk kemi pranuar stafin shtesë të lejuar. Të mallrat dhe shërbimet kemi një realizim të buxhetit 93.2%, të shpenzimet komunale kemi 52% ndërsa të shpenzimet kapitale kemi pas të planifikum një projekt dhe kete projekt më kërkesën tonë dhe pas aprovimit nga ministria e financave një pjesë të këtyre mjeteve i kemi bartë në pozicionin e mallrave dhe shpenzimeve. Total buxheti i shpenzum për vitin 2011 është 88%. Për shpenzimet jashtë vendit krahasuar më vitin 2010 në jemi dikun 45% shpenzime më të ulta .Sa i përket karburantit ka ndodh sepse në edhe kemi vizita edhe monitorojmë në teren kemi pas disa udhëtime edhe jashtë si Shqipëri, Maqedoni, Bullgari dhe keto e kanë ngarkuar totalin e buxhetit.

Latif Gashi, në bazë të sqarimeve që u ofruan, mendojë se duhet të aprovojme raportin. Herave tjera raporti të jetë më i detalizuar me specifikime të caktuara për kategoritë dhe nënkategoritë ekonomike.

Sali Asllanaj, vlerësoi të larta shpenzimet për këtë institucion të vogël, rasti i shpenzimeve të udhëtimit jashtë vendit, i karburanteve.

Pas diskutimeve, Komisioni me Shtatë votë Për (Safete Hadergjonaj, Jelena Bontic, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Muhamet Mustafa, Xhevdet Neziraj, Hykmete Bajrami dhe Duda Balje), një Kundër (Sali Asllanaj,) dhe një Abstenim (Albana Fetoshi), nxori këtë

REKOMANDIM

I rekomandohet Kuvendit të miratojë raportin financiar të AKK-së për vitin 2011.

7. Shqyrtimi i Raportit financiar të Zyrës Rregullative për Ujësjellës dhe Mbeturina për vitin 2011

Kryetarja, njoftoi se grupi punues i ka mbajtur dy takime që është shqyrtu raporti vjetor i financiar i ZRRUM-së. Pas analizimit të buxhetit kemi vlerësuar se ka nevojë për detalizime të shpenzimeve, të cilat janë kërkuar nga ZRRUM-së dhe ato janë sjellur më në detale.

Raif Preteni, raportoi se ZRRUM në vitin 2011 ka pas një mungesë në paga dhe meditje prej 6.600 euro prej buxhetit dhe ndërkohë është zgjidhur ky problem. Në vazhdim sqaroi se shpenzimet sipas kategorive. Suficiti prej 5.906 euro në kategorinë paga dhe meditje, ka ndodhur për arsye që nuk kemi pasur ankesa prej komisionit për shqyrtimin e vendimeve rregullatore. Në kategorinë mallra dhe shpenzime kanë mbetur si suficit 35.764 euro arsyet e mos shpenzimeve të këtyre mjeteve kanë qen sepse 22.824 kanë mbetur të zotuar që në mungesë të stafit nuk kemi mujtë të përfundojmë procedurat e prokurimit. Në kategorinë e shërbimeve komunale kemi një suficit prej 2.125 euro arsyeja e këtij deficiti është se për tre muajt e fundit të vitit 2011 KEK nuk ka sjell fakturat e rrymës elektrike si dhe kompania e pastrimit për asnjë muaj të vitit 2011 nuk ka sjell faturën për pagesë për shërbimet e ofruara. Gjendja e kompanive të mbeturinave është shumë e keqe por në vitin 2011 ka një inkasimi mbi 53%, gjendja është më e mirë se vitin 2010 ka një ngritje të shkallës së inkasimit nga 66 në 68 dhe rregullisht i paguajnë tatimet e ndryshme por edhe licencën e zyrës së rregullatorit. Në bazë të ligjit zyra e rregullatorit ka licencuar vetëm shtatë kompani në shtatë qendra të kompanive të mbeturinave por ato privat ka licencuar ministria e ambientit. Ne e kemi bërë që qdo shtëpi me pas orëmatësin dhe me pague aq sa harxhon. Humbjet e ujit janë diku 61%.

Hasime Krasniqi, Pyetja ime ka të bëjë me punëtorët të cilet janë këtu a janë staf shërbyes civil apo në ndonjë kategori tjetër duke u bazuar në pagat të cilat i kanë. Pos kësaj lidhur me gjendjen e kompanive edhe pse ndoshta kjo nuk është veprimtari e komisionit tonë, gjendja e kompanive, mbeturinave, ujit cilat janë strategjitë e juaja për vitin 2012 për të dal nga kjo krizë?

Raif Preteni, Pagat janë caktuar në vitin 2008 dhe nuk kanë lëvizë nga Kuvendi i Republikës së Kosovës nga komisioni për buxhet dhe financa. Unë kam ardhur në vitin 2010 dhe ato paga janë nga atëherë, ato paga deri në aprovimin e ligjit të ri nuk kanë qenë shërbyes civil, e tash pos drejtorit dhe levendes drejtorit që emërohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës janë kthyer në shërbyes civil mirëpo pagat kanë mbetur nga viti 2008 që i ka përcaktuar ky komision.

Kryetarja, theksoi se ne kemi miratuar marrëveshjet e financimit të nënshkruara me institucione të ndryshme dhe Qeverisë për më përmisua jetën e qytetarëve sidomos kur është në pyetje termokosi dhe ujësjellësi dhe nëse ai projekt i huaj i vendos edhe orëmatësit dhe nuk inkasohet sipas orëmatësive, atëherë ska pse fajësohet konsumatori.

Pas diskutimeve Komisioni njëzëri nxori këtë

REKOMANDIM

I rekomandohet Kuvendit të miratojë raportin financiar të ZRRUM-së për vitin 2011.

8. Shqyrtimi i Projektligji nr.04/L-066 për Qendrën Historike të Prizrenit me Raportin me amendamente të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Komisioni me Shtatë votë Për (Safete Hadergjonaj, Jelena Bontic, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Muhamet Mustafa, Sali Asllanaj, dhe Duda Balje), Një Kundër (Albana Fetoshi,) dhe dy Abstenime (Xhevdet Neziraj dhe Hykmete Bajrami), nxori këtë

REKOMANDIM

Projektligji dhe amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

9. Shqyrtimi i Raportit me amendamente të Grupit Punues të Komisionit për Buxhet për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-146 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar

Grupi punues i Komisionit, raportoi për punën e bërë në amendamentimin e Projektligjit. Ndryshimet e propozuara kanë për qëllim rregullimin gjuhësor dhe teknik dhe përshtatjen e dispozitave në pajtim me standardet gjuhësore dhe juridike të hartimit të legjislacionit. Me amendamentin 11, Neni 27, paragrafi 1, në rreshtin e tretë pas fjalëve “i Nenit 28 të këtij *Ligji*”, janë shtuar fjalët ”, për të cilën periudha kalimtare përfundon më 31 dhjetor 2014.” Ka qenë një propozim i Ministrisë së Financave që të shtohet kjo fjali që ka për qëllim që lirimet për transaksionin e sigurimeve dhe risigurimit duke përfshirë shërbimet e lidhura të bëra nga brokerat e sigurimit dhe agentet e sigurimit, të vendosur me ligjin bazik, të përfundojnë në vitin 2014. Me këtë propozim është pajtuar njëzëri grupi punues.

Komisioni njëzëri nxori këtë

REKOMANDIM

Miratohen propozim-amendamentet e grupit punues të Komisionit për Buxhet për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-146 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar dhe raporti me amendamente procedohet për shqyrtim dhe miratim në procedurë të mëtutjeshme në Kuvend.

Mbledhja përfundoi: 15:40

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Safete Hadergjonaj